



Forcimi i komunitetit të inovacionit në Evropën Juglindore: EIT Manufacturing krijon qendrën e saj në Athinë - Greqi

Rrjeti evropian i inovacionit [EIT Manufacturing](#) është në proces të krijimit të një qendre të re inovacioni të quajtur Co-Location Center Juglindore (Co-Location Center South-East, CLC SE). EIT Manufacturing, është Komuniteti i Dijes dhe Inovacionit i fokusuar në prodhim (manufacturing-focused Knowledge and Innovation Community) brenda Institutit Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT) - [European Institute of Innovation and Technology \(EIT\)](#), është një organ i Bashkimit Evropian.

CLC SE është qendra e gjashtë e prodhimit të EIT dhe do t'i shërbejë tetë vendeve në Evropën Juglindore (South-East Europe): Shqipërinë, Bullgarinë, Qipron, Greqinë, Moldavinë, Maqedoninë e Veriut, Rumaninë dhe Turqinë. Këto shtete, për EIT Manufacturing, janë fokusi kryesor strategjik dhe ka potencial të madh për zhvillimin dhe forcimin e Industrisë Prodhuese Evropiane (European Manufacturing Industry). Qendra, aktualisht e vendosur në Vjenë, i shërben komunitetit të industrisë prodhuese në këto vende. Vjena do të vazhdojë të udhëheqë rrugën në fazën e përsheptimit të qendrës së Athinës për të siguruar shërbim të pandërprerë.



Përshkrimi i fotografisë: Udhërrëfyesi për krijimin e qendrës së inovacionit të prodhimit EIT (EIT Manufacturing) të Athinës u përcaktua gjatë seminareve të mbajtura në Prill.

CLC SE e Athinës do të synojë përsheptimin e sinergjive ndërkombëtare ndërmjet lojtarëve të ndryshëm të ekosistemeve rajonale prodhuese (regional manufacturing), duke përfshirë ndërmarrjet fillestare, ndërmarrjet e shkallës, kompanitë prodhuese, ofruesit e zgjidhjeve, Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM - SME), universitetet dhe institutet kërkimore. Objektivi do të jetë zgjerimi i rrjetit ekzistues rajonal të inovacionit duke tërhequr dhe mirëpritur më shumë palë të interesuara nga ekosistemet lokale për të bashkëpunuar me EIT Manufacturing, në mënyrë që, nga ana tjetër, partnerët dhe anëtarët të mund të



përfitojnë nga bashkëpunimi i frytshëm në projektet e partneritetit publik-privat. Kështu, partnerët dhe anëtarët do të mund të përfitojnë nga bashkëpunimi efikas në projektet e partneritetit publik-privat.

Me përjashtim të Shqipërisë dhe Moldavisë vendet për të cilat do të interesohet ekipi i ardhshëm i Co-Location Center së Athinës klasifikohen si novatorë të moderuar ose modest, sipas Tabelës Evropiane të Inovacionit (European Innovation Scoreboard). Prandaj, vendet përkatëse janë të pranueshme për Planin Rajonal të Inovacionit të EIT RIS - EIT Regional Innovation Scheme (RIS). EIT RIS do të ofrojë një nivel shtesë të mbështetjes së personalizuar për novatorët në vendet e synuara.

Dr. Niki Kousi, Drejtoreshë e Përkohshme e CLC SE, e cila do të ndërtojë organizatën, komenton: “Duke pasur parasysh rolin jetik të prodhimit (manufacturing) dhe inovacionit në zhvillimin e ardhshëm ekonomik të rajonit, zgjerimi i Komunitetit të Dijeve dhe Inovacionit të Prodhimit të EIT (EIT Manufacturing’s Knowledge and Innovation Community) drejt Evropës Juglindore (South-East Europe) do t’u shtojë vlerë produkteve, proceseve dhe shërbimeve të zhvilluara nga bizneset fillestare dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM - SME-të). Ai do të frymëzojë krijimin e kompanive prodhuese-manufacturing konkurruese dhe të qëndrueshme globalisht. Në komplementaritetit, rritja e kapacitetit inovativ të vendeve përkatëse të pranueshme për EIT RIS do të jetë një nga objektivat strategjikë të qendrës. Kjo do të arrihet përmes bashkëpunimit të ngushtë me qendrat EIT RIS të krijuara tashmë në vendet tona anëtare.”



Pas themelimit të EIT Manufacturing në 2019, do të ketë përfitim nga ekosistemet ekzistuese, pesë Co-Location Centers e para u themeluan në zona që mund të preknin ekosistemet ekzistuese dhe të ndihmonin në përsheptimin e inovacionit në të gjithë Evropën. Këto qendra në Darmstadt (Gjermani), Gothenburg (Suedi), Milano (Itali), San Sebastian (Spanjë) dhe Vjenë (Austri) kanë ndihmuar në formimin e një komuniteti të fortë të prodhimit EIT në mënyrë që qendra e re të mund të fitojë tërheqje në terren të përgatitur mirë.

“Themeli i Co-Location Center sonë, e cila do të jetë në Athinë, është një hap drejt një epoke të re”, thotë Klaus Beetz, CEO i EIT Manufacturing. “Kur filluam ndërtimin e EIT Manufacturing, ne premtuam të shpërndajmë aktivitetet në të gjithë Evropën dhe të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë për të mirën e prodhimit të ardhshëm Evropian. Me Co-Location Center e re në Greqi, ne jemi në gjendje të forcojmë aktorët e prodhimit dhe inovacionit në rajon, duke ndjekur në të njëjtën kohë më nga afër mundësitë me potencial të madh inovacioni për prodhimin Evropian.”





Profesori Panagiotis Stavropoulos, Shefi i Laboratorit të Sistemeve të Prodhimit dhe të Automatizimit (Laboratory for Manufacturing Systems and Automation LMS/LSP), të Universitetit të Patrës, Greqi, komenton këto: “Jemi të lumtur të nisim këtë aktivitet dhe të shohim partnerë industrialë rajonalë të etur për t'u bashkuar me ekosistemin e prodhimit të EIT. Ne besojmë se Co-Location Center e re, dhe rrjedhimisht Evropa Juglindore, mund të japë një kontribut të rëndësishëm në vizionin Evropian të inovacionit të prodhimit global të udhëhequr nga EIT Manufacturing.”



Informacioni i Sfondit

[EIT Manufacturing](#) mbështetet nga Instituti Evropian i Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT) - [European Institute of Innovation and Technology \(EIT\)](#), është një organ i Bashkimit Evropian. Qëllimi kryesor i EIT Manufacturing është të bashkojë aktorët evropianë të fokusuar në prodhim në ekosistemet e inovacionit që u shtojnë vlerë unike produkteve, proceseve dhe shërbimeve evropiane dhe frymëzojnë krijimin e një prodhimi konkurrues dhe të qëndrueshëm globalisht. EIT Manufacturing bashkon më shumë se 80 organizata anëtare (universitete, institute kërkimore dhe biznese).

Instituti Evropian i Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT) - [European Institute of Innovation and Technology \(EIT\)](#), forcon aftësinë e Evropës për të inovuar duke fuqizuar zgjidhjet për sfidat urgjente globale dhe duke ushqyer talentin sipërmarrës për të krijuar rritje të qëndrueshme dhe vende pune të aftë në Evropë. EIT është një organ i BE-së i cili është pjesë integrale e Horizon Europe, Programi Kuadër i BE-së për Kërkim dhe Inovacion. Instituti mbështet zhvillimin e partneriteteve dinamike pan-Evropiane – Komunitetet e Dijes dhe Inovacionit EIT – ndërmjet kompanive kryesore, laboratorëve kërkimor dhe universiteteve.

EIT Manufacturing - E Bën Reale Inovacionin!

Detajet e Kontaktit

Cristina CARNEIRO, Drejtoreshë e Komunikimeve të EIT Manufacturing,
communications@eitmanufacturing.eu

Dr. Niki KOUSI, Drejtoreshë e Përkohshme e EIT Manufacturing e Qendrës Juglindore (Co-Location Center South-East, CLC SE), niki.kousi@eitmanufacturing.eu

Për më shumë informacione mund ti drejtoheni faqes së adresës <https://www.eitmanufacturing.eu/>.